

Në bazë të nenit 29 paragrafi 3 të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.13.06), Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajur më 24.12.2006 solli

**V E N D I M**  
**PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE MATERIALE**  
**PËR INFORMATËN E DHËNË NGA POSEDUESI I INFORMATAVE**

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet kompensimi material i shpenzimeve për informatën e dhënë nga poseduesi i informatave

Neni 2

(1) Kërkuesi i informatës për përshkrimin që e merr, fotokopjen ose përshkrimin elektronik të informatës, nuk paguan kompensim.

(2) Kompensimi për informatën e dhënë në llojin e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni është:

- për shumëzimin e një flete, A-4 format: 1denar,
- për shtypjen me ngjyra të një flete, A-4 format: 2 denarë,
- për përshkrimin elektronik të informatës në një CD kompjuterike: 21 denarë
- për përshkrimin e një faqeje të fletës, A- 4 format: 5 denarë.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Nr.19-6310/1  
24 dhjetor 2006  
Shkup

Kryetari i Qeverisë së  
Republikës së Maqedonisë  
M-r. Nikolla Gruevski